

**VENDIM**  
**Nr. 395, datë 9.6.2022**

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË NDIHMËS  
SHTETËRORE**

*( ndryshuar me Vendimin nr. 238, datë 17.4.2024; nr. 281, datë 21.5.2025)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si më poshtë vijon:
  - *z. Blendi Gonxhja – kryetar;*
  - *znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;*
  - *znj. Keida Qirko – anëtare;*
  - *z. Besnik Çina – anëtar;*
  - *z. Ahmet Mançellari anëtar.*
2. Trajtimi financiar i anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore bëhet sipas vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.
3. Vendimi nr. 225, datë 26.4.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**